



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për transparencë në komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës,, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2021, miratoi këtë,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

- **Propozim Rregullorja e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”**

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat nga data **05 maj 2021 deri më 07 qershor 2021**, ndërsa debati publik me qytetarë dhe mbahet më **10 maj 2021** duke filluar nga ora **14 ;00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe teuta.ismajli@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (**rubrika; aktet për diskutim publik**)

Neni 5

Diskutimi/debati publik zbatohet nga Drejtoria e Kulturës rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, dhe Teatrin e qytetit “Avdush Hasani” që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot.01-016/0035817/21
Podujevë,
29 prill 2021


Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Propozim

**RREGULLORE
E PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT TË QYTETIT
TË PODUJEVËS “AVDUSH HASANI”**

Podujevë, prill 2021

Në bazë të nenit 12.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L- 040, Ligjit për Teatrot nr.04/L-106, neni 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, neni 15 paragrafi 2.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, si dhe Statutit të Teatrit Publik të Qytetit “Avdush Hasani” nr.prot.01-640-93374 të datës 28 dhjetor 2016, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kuvendi të Komunës së Podujevës, i;

Propozon

**RREGULLORE
E PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT TË QYTETIT
TË PODUJEVËS “AVDUSH HASANI”**

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

1. Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit Publik të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani” (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli).
2. Këshilli emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës, dhe punën e tij e bazon sipas Ligjit për Teatrot në fuqi dhe Statutin e Teatrit “Avdush Hasani”.
3. Çështjet dhe pyetjet me rëndësi nga fushëveprimi i Këshillit, shqyrtohen në takimet e Këshillit Drejtues.
4. Secili anëtar i Këshilli duhet, që sipas përgjegjësisë së tij kolektive të respektojë Ligjin në fuqi, Statutin e TEATRIT “AVDUSH HASANI”, dhe aktet tjera, si dhe të zbatojë vendimet e mbledhjes së përgjithshme, në pajtueshmëri me ligjin.
5. Sipas legjislacionit në fuqi, fushëveprimi i Këshillit është:
 - 5.1. Mbikëqyrë punën e teatrit.
 - 5.2. Aprovon politikën afatgjatë dhe programin në zhvillimin e teatrit dhe politikën artistike.
 - 5.3. Me propozim të drejtorit të teatrit, miraton planin vjetor buxhetor të teatrit.
 - 5.4. Me propozim të udhëheqësit artistik dhe në përputhje me buxhetin vjetor miraton programin artistik vjetor të teatrit.
 - 5.5. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar dhe raportin e punës të teatrit;
 - 5.6. Harton dhe propozon statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të teatrit të cilat i miraton Kuvendi i Komunës së Podujevës.
 - 5.7. Interviston kandidatët dhe zgjedh drejtorin dhe udhëheqësin artistik të teatrit;
 - 5.8. Inicon procedurën dhe bënë shkarkimin e drejtorit dhe udhëheqësit artistik;
 - 5.9. Kryen punë dhe detyra tjera të përcaktuara me ligj, Statut të Teatrit “Avdush Hasani” dhe akte tjera perkatëse të Kuvendit të Komunës së Podujevës.
6. Anëtarët e Këshillit drejtues për punën e tyre i përgjigjen dhe i raportojnë Kryetarit të Komunës.

Neni 2

Përbërja dhe mandati i Këshillit Drejtues

1. Këshilli përbëhet nga pesë (5) anëtarë, me mandat katër (4) vjeçar.
2. Njëri prej pesë (5) anëtarëve të Këshillit duhet të jetë përfaqësues i Komunës së Podujevës
3. Anëtarët e Këshillit drejtues duhet të jenë persona kredibil, me autoritet dhe me përgatitje profesionale në fushën e teatrit.
4. Këshillin drejtues të teatrit të qytetit e emëron dhe shkarkon Kryetari i Komunës.
5. Konstituimin e Këshillit drejtues të teatrit të qytetit e konstituon Kryetari i Komunës.
6. Mbledhjen e parë e thërret dhe e udhëheq anëtari më i moshuar i Këshillit.
7. Kryetari i Këshillit zgjidhet në mbledhjen e parë me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve.
8. Këshilli drejtues i teatrit i paraqet Kryetarit të Komunës së paku një (1) herë në vit raportin e punës së teatrit.

Neni 3

Përgatitja dhe thirrja e mbledhjeve të Këshillit Drejtues

1. Mbledhjet i thërret dhe kryeson, Kryesuesi i Këshillit Drejtues.
2. Në rast të mungesës së Kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit.
3. Anëtarët e Këshillit ftohen së paku dy ditë para mbajtjes së mbledhjes. Ftesa dhe agjenda e propozuar dërgohen me shkrim, e-mail, apo çfarëdo forme tjetër të informimit.
4. Këshilli ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku 3 anëtarë.
5. Propozimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë, atëherë vendos vota e dy fishtë e kryesuesit.
6. Kryesuesi i Këshillit është i obliguar të thërrasë mbledhje nëse këtë e kërkojnë së paku 3 anëtarë të Këshillit.
7. Mbledhjen e Këshillit mund të kërkojë edhe drejtori i Teatrit "Avdush Hasani".
8. Nëse Kryesuesi i Këshillit, për çfarëdo shkak nuk e thërret mbledhjen e Këshillit, atëherë ky Këshill mund të mblidhet edhe nga propozuesi.
9. Anëtari i Këshillit, është i obliguar rregullisht të jetë prezent në mbledhje të Këshillit, si dhe të shkëmbej informata të rëndësishme për teatrin dhe autoritetin të cilin e ka propozuar.

Neni 4

Udhëheqja e Punës dhe Vendosja në Mbledhje

1. Para fillimit të mbledhjes, kryesuesi e verifikon kuorumin dhe më pas e propozon rendin e ditës.
2. Në mbledhje të Këshillit, mund të jenë prezentë edhe drejtori i Teatrit "Avdush Hasani", e sipas nevojë edhe udhëheqësi artistik, mirëpo pa të drejta votimi.
3. Në mbledhje të Këshillit, mund të jenë prezent edhe persona të tjerët, mirëpo me ftesë të kryesuesit ose me vendimin e Këshillit Drejtues.
4. Në raste kur anëtarit/anëtares të Këshillit, mandati i ndalon edhe para kohës në të cilën është emëruar, anëtarit të ri në Këshill, mandati i zgjatë deri në skadimin e mandatit të anëtarit/anëtares të Këshillit, me kohëzgjatje të paracaktuar.

5. Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, kërkojnë shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit.
6. Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës bëhet veç e veç, sipas rregullit, së pari në parim e pastaj në veçanti.
7. Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryesuesi. Kryesuesi mund të propozojë, për kohëzgjatjen e shqyrtimit/diskutimit.
8. Askush nuk mund ta marrë fjalën në diskutim para se t'ia japë fjalën kryesuesi, t'i ndërhyjë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë të pengojë punën e mbledhjes.
9. Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë anëtarëve të paraqitur.
10. Kryesuesi mbyll diskutimin dhe kërkon, që të kalohet në propozime.
11. Në bazë të propozimeve në material dhe mendimeve të shprehura gjatë diskutimeve, kryesuesi formulon konkluzionet dhe ato i paraqet për votim.
12. Për propozime vendoset me votim të hapur, i cili bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numërim.
13. Propozimi konsiderohet i miratuar, nëse për atë deklarohen me shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.
14. Në raste urgjente Këshilli, mund të sjell vendime edhe në formë të shkruar (postë elektronike, letër postare, faks).

Neni 5

Shkarkimi i Drejtorit

1. Këshilli Drejtues e inicion procedurën dhe vendos për shkarkimin e drejtorit dhe udhëheqësit artistik në këto raste:

- 1.1. Papërgjegjësisë në kryerjen e punëve dhe përmbushjen e detyrave.
- 1.2. Shkeljes së rëndë të dispozitave ligjore dhe të Statutit.
- 1.3. Dëmtim të imazhit të Teatrit.
- 1.4. Dënimet për vepra penale, sipas legjislacionit në fuqi.
- 1.5. Performancës së dobët në punë.

Neni 6

Procesverbali

1. Për punën e Këshillit, në mbledhje mbahet procesverbali.
2. Procesverbalin e udhëheq njëri nga anëtarët e Këshillit.
3. Procesverbali mbi punën e Këshillit përmban të dhënat themelore, dhe atë: ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, shenjën dhe numrin e mbledhjes, numrin e anëtarëve të pranishëm të Këshillit dhe të atyre që nuk janë të pranishëm, personat e tjerë që marrin pjesë, emrin e kryesuesit dhe emrin e procesmbajtësit, rendin e caktuar të ditës, emrat e paraqitësve dhe pjesëmarrësve në diskutim, me përmbajtje të shkurtër të diskutimit dhe rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, mendimet e ndara të anëtarëve të Këshillit dhe çështjet tjera me rëndësi.
4. Në fund të çdo pike të rendit të ditës, shënohet përfundimi sipas rendit të formulimit ashtu si e paraqet kryesuesi.

5. Procesverbali përpunohet në origjinal, në dy (2) kopje, një kopjei dërgohet Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, ndërsa një (1) kopje arkivohet në Teatrin “Avdush Hasani”.

6. Procesverbali origjinal duhet të nënshkruhet nga kryesuesi dhe nga procesmbajtësi dhe ai ruhet me materialin tjetër të mbledhjes në arkivin e teatrit dhe Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Në këtë mënyrë dokumentacioni adekuat do të shërbej si referencë edhe për të ardhmen.

Neni 7

Kompensimi

Kompensimi për anëtarët e këshillit për pjesëmarrje në takime bëhet me shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF).

Neni 8

Dispozitat Kalimtare

Çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, rregullohen me Ligjin për Teatrot nr.04/L- 106 dhe me Statutin e Teatrit “Avdush Hasani” nr.01-640-93374 të datës 28 dhjetor 2016.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Nr.prot.01-016/01-0033586/21
Podujevë,
19 prill 2021

Drejtori i DKRS
Elhame Kutllovci

